

V E N D I M
Nr. 346, datë 29.7.1999

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË NJË TRUALLI ME
SIPËRFAQE 970 M2 NË PARKUN E MADH TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, në pronësi të z. Paulin Markaj, me sipërfaqe 970 m2, për qëllime strategjike, të mbrojtjes kombëtare e të rendit publik, me vendndodhje në Parkun e Madh të Tiranës, në territorin e Bashkisë së Tiranës.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Rendit Publik.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme i cili shpronësohet kompensohet me vlerë të plotë, me 6 840 440 (gjashtë milionë e tetëqind e dyzet mijë e katërqind e dyzet) lekë.
 4. Fondi për kompensimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme që do të shpronësohet të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.12.1999.
 6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko